



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 22 dhjetor 2010
Nr. Ref.: RK 77/10

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KI 56/09

Parashtruesit

Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë

kundër

Kuvendit Komunal të Prizrenit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtar dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë z. Fadil Hoxha dhe 59 banorë të tjerë nga Komuna e Prizrenit.

Pala kundërshtare

2. Palë kundërshtare është Kuvendi Komunal i Prizrenit.

Objekti i çështjes

3. Objekt i shqyrtimit të rastit është kërkesa e parashtresve, e 11 shatorit 2009, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit Nr. 01/011-3257 të 30 prillit 2009 (në tekstin e mëtejme Vendimi i 30 prillit 2009), të nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Prizrenit.
4. Përveç kësaj, parashtresit e kërkesës kërquan vendosjen e masës së përkohshme duke urdhëruar pezullim të menjëhershëm të përmbarrimit të Vendimit të 30 prillit 2009, si dhe pezullimin e çfarëdo ndërtimi në lagjen Jaglenica në Prizren derisa Gjykata Kushtetuese të vendosë lidhur me këtë çështje.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Ligji), dhe Nenin 54 dhe 55 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Rregullorja e punës).

Faktet siç pohohen nga palët

6. Me Vendimin e 30 prillit 2009 ishte ndryshuar një Vendim i mëparshëm i Kuvendit Komunal të Prizrenit, i vitit 1983, për një Plan Detal Urban (PDU) për lagjen Jaglenica (tani Dardania). Këto ndryshime, në pjesën përkatëse, specifikohen në paragrafët 1 dhe 2 të Vendimit të 30 prillit 2009, ku thuhet me sa vijon:

"Me këtë Vendim ndryshohet një Vendim i mëparshëm për një Plan Detal Urban për ish-lagjen Jaglenica, tani "Dardania", në Prizren, të lëshuar nën Nr. 01/011-72 më 1 qershor 1983 dhe të botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 27/83."

"Ndryshimet ... e PDU-së janë me sa vijon: "Në pjesën grafike të planit teknik në ngastrat kadastrale Nr. 1958, 1960, 1953, 1954 dhe 1960, në vend të një zone të gjelbër ekzistuese, të paraparë në Planin Detal Urban, tani është paraparë ndërtimi i objekteve të larta, të planifikuara për familjet e dëshmorëve dhe për rastet sociale..."

7. Sipas parashtresve të kërkesës, asnjë debat publik dhe/apo pjesëmarrje nuk i parapriu miratimit të Vendimit të 30 prillit 2009. Pala kundërshtare e konfirmoi këtë pohim në parashtresën e vet me shkrim të 11 nëntorit 2010 dhe gjatë seancës publike të mbajtur më 15 korrik 2010.
8. Sipas Nenit 5, Vendimi i 30 prillit 2009 hyri në fuqi që në ditën e miratimit. Ai nuk përmbante asnjë të dhënë për mjete të mundshme juridike.
9. Palët nuk e kontestojnë faktin që Plan Detal Urban i vitit 1983 parashihte një zonë të gjelbër në ngastrat kadastrale Nr. 1958, 1960, 1953, 1954 dhe 1960. Palët po ashtu nuk e kontestojnë faktin që në atë zonë sipas Vendimit të 30 prillit 2009 ishte paraparë ndërtimi i objekteve të larta, të planifikuara për familjet e dëshmorëve dhe për rastet sociale.
10. Sipas pohimeve me shkrim të palës kundërshtare, të 11 nëntorit 2009, "ndërhyrja në atë zonë do ta lehtësojë menaxhimin e mirëfilltë të këtij lokacioni, ... , është e drejtë të thuhet që kjo zonë është shndërruar në deponi të mbeturinave, duke hedhur mbeturina dhe materiale të ndryshme ndërtimore, që shkaktojnë ndotjen e mjedisit."

11. Më 13 korrik 2009, parashtruesit e kërkesës, si anëtarë të së ashtuquajturës “Nisma ad-hoc e komunës së Dardanisë”, dorëzuan një kërkesë në Kuvendin Komunal të Prizrenit me të cilën kërkonin anulimin e Vendimit të 30 prillit 2009. Parashtruesit ia bashkëngjitën kërkesës një peticion të nënshkruar nga 393 banorë të lagjes Jaglenica.
12. Ata kërkuan anulimin e Vendimit të 30 prillit 2009. Në veçanti, parashtruesit përmendën Nenin 69 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Nr. 03/L-040) dhe Nenin 95 të Statutit të Komunës së Prizrenit si bazë juridike për parashtrimin e peticionit. Parashtruesit theksuan se Vendimi i kontestuar ishte miratuar në kundërshtim me nenet përkatëse të Ligjit për Planifikimin Hapësinor (Nr. 2003/14) dhe të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Nr. 03/L-040).
13. Më 11 shtator 2009, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë tek Avokati i Popullit. Më 30 tetor 2009, Avokati i Popullit ia paraqiti një kërkesë urgjente Kryetarit të Komunës së Prizrenit për vënien e masës së përkohshme, në të cilën kërkonte pezullimin e menjëhershëm të çfarëdo ndërtimi në këtë vend derisa Avokati i Popullit ta shqyrtonte rastin më tërësisht, si dhe derisa Gjykata Kushtetuese të merrte vendim meritore për këtë rast.
14. Më 19 prill 2010, parashtruesi i parë, z. Fadil Hoxha, iu ankua Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe i informoi për parregullsitë dhe të metat që i paraprinë miratimit të Vendimit të 30 prillit 2009. Parashtruesit nuk kanë marrë kurrfarë përgjigje me shkrim në kërkesën e tyre.
15. Më 14 maj 2010, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor ftoi për një diskutim publik për ndryshimin dhe plotësimin e PDU-së për lagjen Jaglenica për 24 maj 2010.
16. Sipas pohimeve të palës kundërshtare, diskutimi publik për ndryshimin dhe plotësimin e PDU-së për lagjen Jaglenica u mbajt më 24 maj 2010.
17. Ndërkaq, Vendimi i 30 prillit 2009 nuk u ndryshua në asnjë mënyrë.

Procedura në Gjykatë

18. Më 11 shtator 2009, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me të cilën kërkonin që Gjykata ta vlerësonte kushtetutshmërinë e Vendimit të 30 prillit 2009.
19. Më 17 tetor 2009, parashtruesit e kërkesës e plotësuan kërkesën me argumente shtesë duke kërkuar që Gjykata ta vendoste masën e përkohshme dhe ta urdhëronte palën kundërshtare që të pezullonte menjëherë çdo lloj veprimi ose pune në ngastrën e tokës në fjalë për t’iu shmangur dëmeve të pariparueshme.
20. Më 25 nëntor 2009, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi dhe konkludoi, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të kërkesës, se parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur argumente bindëse të mjaftueshme për ta justifikuar lejimin e kërkesës për masa të përkohshme, sepse zbatimi i Vendimit të 30 prillit 2009, i nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, mund të rezultojë në dëme të pariparueshme për parashtruesit e kërkesës.
21. Më 15 dhjetor 2009, Gjykata Kushtetuese nxori një vendim me të cilin lejonte vendosjen e masës së përkohshme për një kohëzgjatje prej jo më shumë se tre muaj, duke urdhëruar pezullimin e menjëhershëm të përmbarimit të Vendimit të 30 prillit 2009, si dhe pezullimin e çfarëdo ndërtimi në lagjen Jaglenica në Prizren për të njëjtën kohëzgjatje. Më 15 mars 2010, Gjykata Kushtetuese vendosi ta lejonte vazhdimin e masës së përkohshme edhe për 45 ditë. Më 30 prill 2010, Gjykata vendosi ta vazhdonte kohëzgjatjen e masës së përkohshme edhe për dy muaj të tjerë.

22. Më 27 maj 2010, parashtruesit e kërkesës e njoftuan Gjykatën Kushtetuese se pala kundërshtare u kishte shpërndarë ftesë banorëve të lagjes për një diskutim publik për plotësimin dhe ndryshimin e Planit Detal Urban të lagjes Jaglenica. Në ftesën e lëshuar më 14 maj 2010 nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Hapësinor e Komunës së Prizrenit thuhet: "Ftohen qytetaret që me datën 24.05.2010 të marrin pjesë në Diskutimin Publik për ndryshim dhe plotësimin e Planit Detal Urban të lagjes "Jaglenica" - tani "Dardania" ... Për ndërtimin e objekteve të destinuara për familjet e dëshmorëve dhe për rastet sociale."
23. Më 28 maj 2010, Sekretaria e Gjykatës Kushtetuese kërkoi nga Kryetari i Komunës së Prizrenit që të ofronte informata lidhur me detajet e plota për procedurën që shpuri në thirrjen e atij diskutimi publik më 24 maj 2010. Gjykata mori një përgjigje më 4 qershor 2010.
24. Më 16 qershor 2010, Gjyqtari raportues ia prezantoi Gjykatës një raport shtesë. Gjykata e shqyrtoi atë raport po atë ditë dhe vendosi me shumicë votash që kërkesa ishte e pranueshme. Për shkak të ndërlikueshmërisë së rastit, Gjykata gjithashtu vendosi ta mbante një seancë publike. Po atë ditë, Gjykata vendosi, pa paragjykuar rezultatin përfundimtar të kërkesës, që ta vazhdonte masën e përkohshme edhe për 90 ditë, prej 30 qershorit 2010.
25. Seanca publike u mbajt më 15 korrik 2010, në të cilën ishin të pranishëm përfaqësuesit e parashtruesve të kërkesës dhe të Kuvendit Komunal. Një përfaqësues i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor gjithashtu ishte i pranishëm në seancë.
26. Gjykata u takua në seancë të mbyllur më 22 shtator 2010 për ta shqyrtuar kërkesën dhe e miratoi këtë aktgjykim.

Ankesat e parashtruesve të kërkesës

27. Parashtruesit e kërkesës fillimisht u ankuan se u ishin shkelur të drejtat e tyre të garantuara me Nenin 52(2) të Kushtetutës. Ai nen thotë: "Secilit duhet t'i jepet mundësia të dëgjohet nga institucionet publike dhe mendimet e tyre të konsiderohen lidhur me çështjet që kanë ndikim në mjedisin në të cilin jetojnë".
28. Parashtruesit e kërkesës u ankuan po ashtu se ekzistonte rrezik i drejtpërdrejtë që puna në ngastrën e tokës në fjalë do t'u shkaktojte atyre dëme të pariparueshme dhe prandaj kërkuan që Gjykata ta shqiptonte masën e përkohshme me efekt të menjëhershëm.
29. Gjatë seancës publike, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës gjithashtu pohoi se ishin shkelur Neni 45 i Kushtetutës (Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes), Neni 123(3) (Parimet e Përgjithshme të Vetëqeverisjes Lokale), dhe Neni 124 (Organizimi dhe Funksionimi i Vetëqeverisjes Lokale).
30. Parashtruesit e kërkesës u ankuan gjatë tërë procedurës para Gjykatës Kushtetuese se Vendimi i sfiduar i 30 prillit 2009 ishte miratuar në kundërshtim me disa ligje, kryesisht me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Parashtruesit e kërkesës thanë se si i tillë, Vendimi i 30 prillit nuk ishte nxjerrë në përputhje me Kushtetutën dhe prandaj duhej të anulohet.

Komentet e palës kundërshtare

31. Kuvendi Komunal i Prizrenit, në parashtresën me shkrim të paraqitur më 11 nëntor 2009, i kontestoi pohimet e parashtruesve të kërkesës siç ishin paraqitur në kërkesë. Në veçanti, pala kundërshtare tha se Vendimi i 30 prillit 2009 u miratua në përputhje me Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe se ngastra e tokës në fjalë ishte klasifikuar si pronë publike, e

cila i jepte të drejtë Kuvendit Komunal të Prizrenit të ndiqte një zhvillim të balancuar mirë dhe gradual të planifikimit hapësinor të asaj ngastre të tokës.

32. Pala kundërshtare ishte e qartë si në parashtresën e vet me shkrim të 11 nëntorit 2009, po ashtu edhe gjatë seancës publike, të mbajtur më 15 korrik 2010, se Ligji për Planifikimin Hapësinor nuk kërkonte pjesëmarrjen e publikut para se Vendimi i 30 prillit 2009 të miratohej.
33. Më 16 prill 2010, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit e kundërshtoi vendimin e Gjykatës Kushtetuese për vazhdimin e masës së përkohshme edhe për 45 ditë. Pala kundërshtare tha në veçanti se Plani rregullues urbanistik "Dardania 2", i miratuar me Vendimin 01/011-3756, të 17 korrikut 2009, ishte hartuar në përputhje me normat dhe standardet urbane.
34. Më 4 qershor 2010, Drejtoria për Urbanizëm e palës kundërshtare iu përgjigj letrës së Gjykatës të 28 majit 2010 duke e informuar atë se diskutimi publik ishte mbajtur më 24 maj 2010. Duket që me atë rast banorëve të lagjes Dardania 2 (ish-Jaglenica) u ishte prezantuar një plan urban.
35. Nga parashtresa me shkrim e palës kundërshtare, e 4 qershorit 2010, duket që ata ishin për gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi ndërmjet kërkesës së parashtruesve për mbrojtjen e mjedisit dhe interesave të komunës për të ngritur ndërtesa të reja. Në seancën publike, përfaqësuesit e palës kundërshtare sqaruan se një zgjidhje kompromisi do të ishte të rishikohej projekti për ta përshtatur atë me ndërtesat e tjera në atë lagje dhe për ta ulur ndërtesën nga P+4 në P+3 kate.

Komentet e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

36. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si palë e interesuar para Gjykatës Kushtetuese, theksoi në seancën publike të mbajtur më 15 korrik 2010 se pas pranimit të kërkesës së përfaqësuesit të parashtruesve të kërkesës më 16 shkurt 2010, çështja ishte shqyrtuar brenda Ministrisë nga Departamenti për Planifikim Hapësinor dhe nga Instituti për Planifikim Hapësinor.
37. Më 2 korrik 2010, përfaqësuesi i i inspektoratit të Ministrisë bëri një shikim në vend të ngjarjes dhe kërkoi dokumentacion plotësues nga zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor të Komunës së Prizrenit. Ky dokumentacion plotësues nuk u siguroi. Më 5 korrik 2010, Ministria përsëriti kërkesën e sipërpërmendur për dokumentacion plotësues. Megjithatë, Ministria nuk e kishte marrë dokumentacionin plotësues deri në datën e seancës publike.

Pranueshmëria

38. Duhet të rikujtohet që në fillim se, në përputhje me Nenin 113 (7) të Kushtetutës, objekti i shqyrtimit para Gjykatës Kushtetuese është shkelja e supozuar nga organet publike e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë.
39. Si rrjedhojë, në rastin në fjalë, Gjykata Kushtetuese shqyrtoi shkeljen e supozuar, nga pala kundërshtare, të të drejtave dhe lirive të parashtruesve të kërkesës, të garantuara me Kushtetutë, në veçanti Nenin 52 (2) të Kushtetutës.
40. Sa u përket ankesave të tjera, në veçanti atyre që kanë të bëjnë me shkeljen e supozuar të ligjeve, posaçërisht të Ligjit për Planifikim Hapësinor, duhet të theksohet se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e marra nga organet publike, duke përfshirë gjykatat e

rregullta. As nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese thjesht ta vlerësojë ligjshmërinë e aktit të sfiduar, në rastin në fjalë të Vendimit të 30 prillit 2009.

41. Për ta gjykuar kërkesën e parashtruesve, Gjykata Kushtetuese së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë.

42. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet Nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj,”

dhe Nenit 47.2 të Ligjit, i cili thotë që:

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

43. Gjykata Kushtetuese rikujton që kriteri i ngjashëm për pranueshmëri është i paraparë në Nenin 35 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

44. Sipas praktikës së mirëfilltë gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashtruesit e kërkesës duhet t'i shterin mjetet juridike vendëse që janë në dispozicion dhe efektive. Për më tepër, ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut më tej pranoi që rregulli i shterjes nuk është as absolut as në gjendje të zbatohet në mënyrë automatike; me rastin e shqyrtimit nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të kihen parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. Kjo do të thotë ndër të tjera se ai duhet të ketë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve zyrtare juridike në sistemin ligjor të palës kontraktuese në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesve të kërkesës (shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Akdivar kundër Turqisë, të 16 shtatorit 1996.)

45. Për më tepër, në rastet në të cilat mjeti juridik i sugjeruar në të vërtetë nuk ofronte gjasa të arsyeshme për sukses, p.sh. nga pikëpamja e praktikës së vendosur gjyqësore vendore, fakti që parashtruesi i kërkesës nuk e ka shfrytëzuar atë nuk është pengesë për pranueshmëri (shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Pressos Compania Naviera S.A. kundër Belgjikës, të 20 nëntorit 1995, para. 27; Radio Franca kundër Francës, nr. 53984/00, vendimi i 23 shtatorit 2003, para. 33). Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, organet administrative janë element i shtetit që e respektojnë sundimin e ligjit, dhe interesat e tyre përkojnë me nevojën për administrim të mirëfilltë të drejtësisë. Në rastet kur organet administrative refuzojnë ose dështojnë, apo vonohen ta zbatojnë ligjin, garancitë që i gëzon një ndërgjyqës gjatë fazës gjyqësore të procedurës nuk kanë kurrfarë qëllimi (shih *mutatis mutandis*, Hornsby kundër Greqisë, aktgjykimi i 19 marsit 1997, Raportet 1997-II, f. 511, para. 41).

46. Prandaj, Gjykata Kushtetuese duhet të ketë parasysh cilat mjete juridike vendore, sa u përket të drejtave të parashtruesve të kërkesës të garantuara me Nenin 52(2) të Kushtetutës ishin në dispozicion dhe efektive dhe nëse ata i kishin shterur ato.

47. Në të vërtetë, Gjykata Kushtetuese vëren që Vendimi i 30 prillit 2009 ishte miratuar në përputhje me Nenin 15 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor (Ligji Nr. 2003/14, i ndryshuar me Ligjin 2008/03-L-106) i cili përcakton që planet rregulluese urbane do t'i caktojnë kushtet për rregullimin e hapësirës, si dhe rregullat e ndërtimit në ngastrat

tokësore urbane. Këto plane do të shqyrtohen dhe, nëse është nevoja, ndryshohen çdo pesë vjet.

48. Gjykata gjithashtu vëren që parimet themelore të planifikimit dhe rregullimit hapësinor në Ligjin për Planifikimin Hapësinor bazohen në parimet e pranuar ndërkombëtarisht që qartazi përmenden në të. Si i tillë, Neni 3 (b) i Ligjit për Planifikimin Hapësinor garanton promovimin e një procesi të përfshirjes dhe pjesëmarrjes në formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike, të cilat i përfshijnë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet pa diskriminim. Më tej, Neni 3 (c) më tej garanton promovimin e transparencës së plotë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes duke u mundësuar palëve të interesuara qasje në të dhënat dhe hartat planifikuese të nevojshme për pjesëmarrjen e tyre të plotë si e drejtë dhe obligim i qytetarit. Këto parime më tej shtjellohen në Nenin 19 (2) të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, i cili e parashikon obligimin e komunave për të organizuar diskutim publik të planeve hapësinore në kuadër të kompetencave të tyre. Procedura e diskutimit publik të planeve hapësinore dhe urbane shtjellohet më tej në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e Ligjit për Planifikimin Hapësinor mbi procedurën e diskutimit publik për normat hapësinore dhe urbane.
49. Së fundi, Neni 4 i Ligjit për Planifikimin Hapësinor parashikon që dispozitat mbi procedurën e përgjithshme administrative aplikohen për zbatimin e planeve hapësinore dhe urbanistike.
50. Sipas Nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, “ankesat e qytetarëve kundër një akti administrativ të organeve komunave shqyrtohen në përputhje me Ligjin për Procedurën Administrative”.
51. Siç u cek më lart, Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale parashohin zbatimin e Ligjit për Procedurën Administrative sa u përket çështjeve të rregulluara me këto dy ligje.
52. Neni 127 i Ligjit për Procedurën Administrative parashikon që ankimi administrativ mund të bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose të ankesës dhe se çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër një akti administrativ ose kundër refuzimit të paligjshëm për nxjerrjen e aktit administrativ.
53. Në anën tjetër, Neni 131 i Ligjit për Procedurën Administrative parashikon që organi administrativ kompetent shqyrton ankimin administrativ dhe nxjerr vendim brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të ankimit. Për më tepër, sipas paragrafit 2 të të njëjtit Nen, në qoftë se me kalimin e afatit të sipërpërmendur nuk është nxjerrë asnjë vendim mbi ankimin nga organi administrativ kompetent, palëve të interesuara iu lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës në përputhje me ligjin mbi procedurën civile në fuqi.
54. Për t’iu qasur Gjykatës, është me rëndësi së pari të kihet parasysh cila gjykatë është kompetente për çështjen në fjalë. Në Republikën e Kosovës, juridiksioni i gjykatave rregullohet me Ligjin e vjetër jugosllav për Gjykata, të vitit 1978 (shih Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 21/78). Sa u përket çështjeve të ligjit administrativ, Ligji për Gjykata thekson që “Gjykata Supreme vendos për ligjshmërinë e aktit përfundimtar administrativ në një kontest administrativ.”
55. Ndërsa procesi i përgjithshëm administrativ i vendimmarrjes rregullohet me Ligjin për Procedurën Administrative, Ligji për Kontestet Administrative i vitit 1977 (Gazeta Zyrtare Nr. 4/77) zbatohet për rastet para Gjykatës Supreme të Kosovës.
56. T’i kthehemi rastit në fjalë, parashtruesit e kërkesës iu ankuan Kuvendit Komunal më 13 korrik 2009 lidhur me Vendimin e 30 prillit 2009, të miratuar pa pjesëmarrje publike.

Parashtruesit e kërkesës kurrë nuk morën përgjigje në petitionin e tyre të 13 korrikut 2009, ndonëse ishte nënshkruar nga 393 banorë të lagjes Jaglenica. Me sa duket, ai thjesht ishte injoruar.

57. Parashtruesit e kërkesës më pas iu drejtuan Avokatit të Popullit, kësaj Gjykate dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Duhet të rikujtohet që një kontest administrativ në rastin e heshtjes administrative mund të iniciohet vetëm kundër një akti administrativ “për të drejtën e posaçme të një personi apo organizate të posaçme në një çështje administrative.” Si rrjedhojë, Ligji për Kontestet Administrative që zbatohet në Republikën e Kosovës duket që nuk lejon ankesë gjyqësore nëse nuk ka pasur shkelje të drejtpërdrejtë të së drejtës apo interesit ligjor të një individi.
58. Është e qartë që Vendimi i 30 prillit 2009 nuk është vendim “individual”, dhe për këtë arsye parashtruesit e kërkesës nuk kanë pasur në dispozicion ankesë gjyqësore para Gjykatës Supreme për ta sfiduar Vendimin e 30 prillit 2009 lidhur me të drejtën e garantuar me Nenin 52 të Kushtetutës. Ligji për Kontestet Administrative nuk parashikonte mjete juridike për parashtruesit e kërkesës
59. Duke marrë parasysh të gjitha çështjet e sipërpërmendura, Gjykata është e mendimit që, në përputhje me rrethanat, kërkesa është e pranueshme.

Meritat

60. Neni 52 (2) i Kushtetutës garanton që:

“Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t’i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.”

61. E drejta për të jetuar në mjedis të shëndoshë shpesh klasifikohet në të ashtuquajturën “të drejtat e gjeneratës së tretë”. Të drejtat e gjeneratës së tretë janë të drejta të pranura ndërkombëtarisht si të drejta të njeriut, por që nuk klasifikohen lehtë as si të drejta civile dhe politike apo si të drejta ekonomike dhe sociale. Ato i përfshijnë të drejtat si: të drejtën për vetëvendosje, të drejtën për resurse natyrore, të drejtën për zhvillim ekonomik dhe social, dhe të drejtën për barazi dhe qëndrueshmëri ndërmjet gjeneratave.
62. Në qershor të vitit 1992, Konferenca e OKB-së për Mjedis dhe Zhvillim, në takimin e mbajtur në Rio de Zhanero (Brazil), miratoi një deklaratë (“Deklarata e Rios për Mjedis dhe Zhvillim”, A/CONF.151/26 (Vëll. 1)) që synonte ta avanconte konceptin e të drejtave dhe përgjegjësi të shteteve për mjedisin. “Parimi 10” i kësaj Deklarate thotë: “Çështjet mjedisore trajtohen më së miri me pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve të interesuar në nivelin përkatës. Në nivelin kombëtar, çdo individ do të qetë qasje adekuate në informata që kanë të bëjnë me mjedisin dhe që mbahen nga autoritetet publike, përfshirë këtu edhe informatat mbi materiet e rrezikshme dhe aktivitetet në komunitetet e tyre, dhe duhet t’u ofrohet mundësia për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes. Shtetet duhet ta mundësojnë dhe inkurajojnë ndërgjegjësimin publik dhe pjesëmarrjen publike duke lejuar qasje në informata. Do të lejohet qasje efikase në seancat administrative dhe ligjore, përfshirë edhe riparimin dhe rehabilitimin.”
63. Më 25 qershor 1998, Komisioni Ekonomik i OKB-së për Evropë, me rastin e zbatimit të Parimit 10 të Deklaratës së Rios miratoi të ashtuquajturën Konventa e Aarhusit (“Konventa për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, ECE/CEP/43). Kjo Konventë vë theks në promovimin e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje lidhur me çështjet që ndikojnë në mjedis. Në veçanti, kjo dispozitë është bërë për ta siguruar pjesëmarrjen e publikut që nga fillimi i procedurës për një zhvillim të propozuar, “kur të

gjitha alternativat janë të hapura dhe publiku mund të marrë pjesë në mënyrë efektive". Rezultati i pjesëmarrjes publike duhet të merret parasysh me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar, që gjithashtu duhet të bëhet publik.

64. Më 27 qershor 2003, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi Rekomandimin 1614 (2003) për mjedis dhe të drejtat e njeriut. Pjesa përkatëse e këtij rekomandimi thotë:

9. Asambleja u rekomandon Qeverive të shteteve anëtare:

- i. të sigurojnë mbrojtje përkatëse të jetës, shëndetit, familjes dhe jetës private, integritetit fizik dhe pronës private të personave në përputhje me Nenin 2, 3 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Nenit 1 të Protokollit Shtesë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë edhe nevojës për mbrojtjen e mjedisit;*
- ii. ta njohin të drejtën e njeriut për një mjedis të shëndoshë, të qëndrueshëm dhe modest, i cili e përfshin obligimin objektiv të shteteve për ta mbrojtur mjedisin, në ligjet vendëse, preferohet në nivel kushtetues;*
- iii. t'i mbrojnë të drejtat procedurale të individëve për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t'u drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit siç përcaktohet në Konventën e Aarhusit.*

65. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka dhënë udhëzime të qarta se mbrojtja e mjedisit përfshihet edhe në Nenin 2 (E drejta për jetën) edhe në Nenin 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare). Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku shtetet duhet të vendosin për çështje të ndërlikuara të politikave për mjedis dhe ekonomi, procesi i vendimmarrjes së pari duhet të përfshijë hulumtime dhe studime të mirëfillta për t'u mundësuar atyre që paraprakisht t'i parashikojnë dhe vlerësojnë efektet e atyre veprimeve që mund ta dëmtojnë mjedisin dhe t'i cenojnë të drejtat e individëve, dhe për t'u mundësuar shteteve që të vendosin ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të ndryshme kundërthënëse (shih Hatton dhe të tjerët, para. 128). Rëndësia e qasjes së publikut në konkluzionet e studimeve të tilla dhe në informata që do t'u mundësonin atyre ta vlerësonin rrezikun të cilit i ekspozohen është jashtë çdo dyshimi (shih *mutatis mutandis*, Guerra dhe të tjerët kundër Italisë, aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, Raportet 1998-I, f. 228, para. 60, dhe McGinley dhe Egan kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykimi i 9 qershorit 1998, Raportet 1998-III, f. 1362, para. 97). Së fundi, personat e interesuar gjithashtu duhet të jenë në gjendje të paraqesin ankesë në gjykatë kundër çdo vendimi, akti ose lëshimi, që, sipas mendimit të tyre, nuk u ka kushtuar rëndësi të mjaftueshme interesave apo komenteve të tyre në procesin e vendimmarrjes (shih *mutatis mutandis*, Hatton dhe të tjerët, cituar më lart, para. 127).
66. T'i kthehemi rastit në fjalë, palët nuk e kontestojnë faktin që Vendimi i 30 prillit 2009 ishte miratuar pa diskutim publik apo ndonjë lloj tjetër të pjesëmarrjes publike.
67. Prandaj, Gjykata e ka të qartë se parashtruesit e kërkesës nuk kanë pasur rast të dëgjohen nga institucioni publik, d.m.th, nga pala kundërshtare, dhe ta thonë mendimin e tyre lidhur me çështjet që kanë ndikim në mjedisin në të cilin jetojnë.
68. Ndonëse pala kundërshtare tha në disa raste se është e gatshme të diskutojë për një zgjidhje kompromisi, ajo nuk i trajtoi në mënyrë kuptimplote apo fare nuk i trajtoi ankesat e parashtruesve të kërkesës lidhur me shkeljen e Nenit 52(2) të Kushtetutës.
69. Gjykata thirret në informatat përkatëse dhe në veçanti i referohet praktikës përkatëse gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që ka të bëjë me mbrojtjen e

mjedisit. Gjykata konsideron se është me rëndësi të theksohet që “personat e interesuar gjithashtu duhet të jenë në gjendje të paraqesin ankesë në gjykatë kundër çdo vendimi, akti ose lëshimi, që, sipas mendimit të tyre, nuk u ka kushtuar rëndësi të mjaftueshme interesave apo komenteve të tyre në procesin e vendimmarrjes (shih *mutatis mutandis*, Hatton dhe të tjerët, cituar më lart, para. 127) .

70. Në rastin aktual, siç shtjellohet në pjesën për pranueshmëri më lart, duket që parashtruesit e kërkesës nuk e kanë gëzuar nivelin e kërkuar për mbrojtjen e mjedisit.

71. Prandaj, Gjykata konstaton që ka pasur shkelje të Nenit 52(2) të Kushtetutës.


PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me Nenin 113.7 të Kushtetutës, Nenin 20 të Ligjit, dhe Nenin 54 dhe 55 të Rregullores së punës, GJYKATA

VENDOS


- I. *Me shumicë votash* që kërkesa është e pranueshme.
- II. *Njëzëri konstaton* që ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesve të kërkesës të garantuar me Nenin 52(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
- III. Ky Aktgjykim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me Nenin 20.4 të Ligjit.
- IV. KONSIDERON që Kuvendi Komunal u Prizrenit duhet t’i dorëzojë Gjykatës, brenda gjashtë muajve, informata për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi.
- V. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë dhe mund t’i bëhet rishikim editorial.

Gjyqtari Raportues


Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. Dr. Enver Hasani